

MASAT PËR BANORËT NË ZONAT E IZOLIMIT

Çfarë është koronavirusi?

Koronavirusi (COVID-19) është një sëmundje shumë e ngjashme me gripin. Ky virus shkakton shqetësime të rrugëve të frymëmarrjes, kollë dhe temperaturë. Shumica e njerëzve e marrin veten nga virusi (në përgjithësi brenda 7 ditëve). Për më të moshuarit dhe personat me probleme për shembull me mushkëritë, zemrën ose veshkat, virusi mund të jetë më i rrezikshëm.

Koronavirusi transmetohet mes personave. Kur një person i infektuar kollitet ose nxjerr frymën, virusi shpërndahet përmes grimcave të vogla nga hunda ose goja. Një person i infektuar mund ta transmetojë virusin edhe përmes kontaktit me duart. Nëse jeni i sëmurë, duhet të siguroheni që të mos infektoni të tjerët.

Cilat janë simptomat?



Temperaturë
(mbi 37,5°C)



Kollë dhe/ose
teshtima



Dhimbje fyti



Vështirësi në frymëmarrje

Çfarë është zona e izolimit?

Zona e izolimit është një dhomë në qendrën e pritjes ku personat duhet të mbahen të izoluar për një minimum prej 7 ditësh. Personat në zonën e izolimit nuk mund të kenë kontakt me banorët e tjerë në qendrën e pritjes. Ky izolim (ndarje) është i nevojshëm për të parandaluar që të tjerët të sëmuren dhe për të mos lejuar që të tjerët të sëmuren dhe për të ndaluar përhapjen e mëtejshme të koronavirusit.

Masat në zonën e izolimit

Gjatë qëndrimit tuaj në zonë e izolimit, ju duhet të ndiqni këto masa. Në këtë mënyrë, mund të siguroheni që nuk do t'i infektoni me koronavirus njerëzit që hyjnë në zonën e izolimit.



Qëndroni në dhomën tuaj

- Qëndroni në dhomën tuaj ose në zonën e izolimit.
- Largohuni nga zona e izolimit vetëm për arsye urgjente ose sanitare.
- Mbani maskë kur largoheni nga zona e izolimit.



Higjiena juaj personale

- Lajini duart shumë rregullisht me ujë e sapun
 - përpara se të hani
 - çdo herë pasi të shkoni në banjë
 - pasi kolliten ose teshtini
 - sa herë që dilni nga dhoma
- Prekeni fytyrën sa më pak që të jetë e mundur.
- Vazhdoni të kujdeseni për higjienën tuaj personale.






Përdorni kartëpeceta

- Përdorni një kartëpecetë të re kur kolliteni ose teshtini.
- Hidhni kartëpecetat në një kosh mbeturinash me kapak.
- Nëse nuk keni kartëpecetë, atëherë kollituni ose teshtini në pjesën e brendshme të bërrylit.



Mos i ndani me të tjerët gjërat tuaja

- MOS i ndani me të tjerët gjërat tuaja (furçën e dhëmbëve, takëmet, rrobat, peshqirin, çarçafët).
- MOS i ndani me të tjerët cigaret tuaja.




Mbani një distancë

- Mbani një distancë 1,5 metra nga personat e tjerë (nëse është e mundur, edhe 1 metër distancë në dhomën tuaj)
- Nuk lejohet që të prisni vizitorë në dhomë apo në zonën e izolimit.
- Mos e mbani maskën e fytyrës në zonën e izolimit.
- Vetëm personeli që duhet të hyjë në zonën e izolimit do të mbajë maskë fytyre.



Mbajeni dhomën tuaj të pastër

- Pastroni çdo sipërfaqe që prekni (tavolinën, dorezat e dyerve, dyshtimet, ndenjësën e tualetit etj.) duke përdorur çdo ditë një produkt pastrimi.
- Shkarkoni galixhantin e tualetit me kapak të ulur.
- Vendosini rrobat e palara në qesen që ju jepet. Rrobat do t'i marrim dhe t'i lajmë ne për ju.
- Hapeni dritaren 3 herë në ditë për të ajrosur dhomën.
- Hidhni të gjitha mbeturinat, kartëpecetat dhe mbetjet në kosh. Mbyllni kapakun e koshit.



Hani në dhomën tuaj

- Ushqimet do t'ju sillen në dhomë. Mos shkoni në mensë.
- Pas ushqimit, nëse është e mundur, lajini materialet e ripërdorshme me ujë e sapun dhe lërinini gati pranë derës së dhomës. Këto materiale do t'i mbledhim ne.



Kujdesi juaj mjekësor

- Një anëtar i ekipit mjekësor do t'ju vizitojë rregullisht në zonën e izolimit. Ndiqni udhëzimet e tyre me përpikëri.
- Nuk lejohet që të vizitoni vetë shërbimin mjekësor ose receptionin.
- Nëse ju nevojitet dikush nga ekipi (mjekësor) për shkak se po ju përkeqësohen simptomat (temperaturë e lartë, vështirësi në frymëmarrje), atëherë ju lutemi kontaktoni me
- Qëndroni në dhomën tuaj dhe prisni.
- Nëse është e nevojshme, doktori ose infermieri do të vijë t'ju vizitojë në dhomë.



Mos u dekurajoni!

E dimë se jeta në izolim nuk është e lehtë. Ju lutemi kini parasysh se qëndrimi juaj në zonën e izolimit është i përkohshëm. Duke i ndjekur këto masa me përpikëri, ju po siguroheni që nuk do të sëmuren miqtë tuaj, shokët dhe çdo person tjetër në qendrën e pritjes. Kjo ju bën juve si hero për personat që ju njohin. Faleminderit që po ndiqni masat dhe ju urojmë shërim të shpejtë!

Keni ndonjë pyetje? A ndiheni i mërziur? Mund të kontaktoni me ekipin mjekësor ose personelin e qendrës së pritjes në